

# Standardi Ndërkombëtar I Kontabilitetit 29

## Raportimi Financiar në Ekonomitë Hiperinflacioniste

### Objekti

---

- 1 Ky Standard duhet të zbatohet për pasqyrat financiare, përfshirë pasqyrat financiare të konsoliduara, të çdo njësie ekonomike e cila ka si monedhë funksionale monedhën e një ekonomie hiperinflacioniste.
- 2 Në një ekonomi hiperinflacioniste, raportimi i rezultateve të shfrytëzimit dhe gjendjes financiare në monedhën vendase pa riparaqitje nuk është i dobishëm. Paraja humbet fuqinë blerëse me një normë të tillë sa që krahasimi i shumave nga transaksionet dhe ngjarjet e tjera që kanë ndodhur në kohë të ndryshme, edhe brenda të njëjtës periudhë kontabël, është çorientues.
- 3 Ky Standard nuk përcakton një normë absolute se kur gjykohet se ka hiperinflacion. Është një çështje e gjykimit se kur është e nevojshme riparaqitja e pasqyrave financiare në përputhje me këtë Standard. Hiperinflacioni shfaqet me karakteristikat e një mjedisi ekonomik të një vendi që përfshin, por nuk kufizohet vetëm me sa mëposhtë:
  - (a) popullata në përgjithësi preferon të mbajë pasurinë e saj në aktive jo-monetare ose në monedhë të huaj relativisht të qëndrueshme. Shumat e mbajtura në monedhën vendase investohen menjëherë për të ruajtur fuqinë blerëse;
  - (b) popullata në përgjithësi trajton shumat monetare jo në vlerën e monedhës vendase por në vlerën e një monedhe të huaj relativisht të qëndrueshme. Çmimet mund të kuotohen në këtë monedhë;
  - (c) shitjet dhe blerjet me kredi kryhen me çmimet që kompensojnë humbjen e pritshme të fuqisë blerëse gjatë periudhës së kreditimit, edhe kur periudha është e shkurtër;
  - (d) përqindjet e interesit, pagat dhe çmimet janë të lidhura me një indeks çmimesh; dhe
  - (e) përqindja e akumuluar e inflacionit gjatë tre vjetëve i afrohet ose tejkalon 100%.
- 4 Është e preferueshme që të gjitha njësitë ekonomike që raportojnë në monedhën e të njëjtës ekonomi hiperinflacioniste të zbatojnë këtë Standard nga e njëjta datë. Megjithatë, Ky Standard zbatohet për pasqyrat financiare të çdo njësie ekonomike nga fillimi i periudhës raportuese në të cilën ajo identifikon ekzistencën e hiperinflacionit në vendin me monedhën e të cilit ajo raporton.

### Riparaqitja e pasqyrave financiare

---

- 5 Çmimet ndryshojnë me kalimin e kohës si rezultat i forcave të ndryshme të veçanta ose të përgjithshme politike, ekonomike dhe shoqërore. Forcat e veçanta të tilla si ndryshimet në ofertë dhe kërkesë dhe ndryshimet teknologjike mund të shkaktojnë rritjen ose uljen e rëndësishme të çmimeve dhe në mënyrë të pavarur nga njëri tjetri. Veç kësaj, forcat e përgjithshme mund të rezultojnë në ndryshime në nivelin e përgjithshëm të çmimeve dhe për këtë në fuqinë blerëse të përgjithshme të pasasë.
- 6 Në shumicën e vendeve, pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e kontabilitetit të koston historike pa marrë parasysh qoftë ndryshimet në nivelin e përgjithshëm të çmimeve, qoftë rritjet në çmimet e veçanta të aktiveve të mbajtura, përveç rasteve të rivlerësimit të tokës, ndërtesave, makinerive dhe pajisjeve. Disa njësi ekonomike, megjithatë, paraqesin pasqyrat financiare që bazohen në metodën e koston aktuale e cila pasqyron efektet e ndryshimeve në çmimet e veçanta të aktiveve të mbajtura.
- 7 Në një ekonomi hiperinflacioniste, pasqyrat financiare, qoftë kur ato janë bazuar në metodën e koston historike, qoftë në metodën e koston aktuale, janë të dobishme vetëm nëqoftëse ato shprehen në një njësi matëse aktuale në datën e nxjerrjes së bilancit. Si rrjedhim, ky Standard zbatohet për pasqyrat financiare të njësisve ekonomike që raportojnë në monedhën e një ekonomie hiperinflacioniste. Paraqitja

e informacionit të kërkuar nga ky Standard si një shtesë e pasqyrave financiare të pa rideklaruara nuk lejohet. Më tej, paraqitja e veçantë e pasqyrave financiare përpara riparaqitjes nuk është e dëshiruar.

- 8 **Pasqyrat financiare të një njësie ekonomike e cila ka si monedhë funksionale monedhën e një ekonomie hiperinflacioniste, qoftë kur ato janë bazuar në metodën e kostos historike ose qoftë në metodën e kostos aktuale, duhet të shprehen në vlerat e një njësie matëse aktuale në datën e bilancit. Shifrat korresponduese për periudhat e mëparshme që kërkojnë nga SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare* dhe çdo informacion në lidhje me periudhat më të herëshme gjithashtu duhet të paraqitet me vlerën e njësisë matëse aktuale në datën e bilancit. Për qëllimin e paraqitjes së shumave krahasuese në një monedhë paraqitje të ndryshme, zbatohen paragrafët 42(b) dhe 43 të SNK 21 *Efektet e Ndryshimeve në Kurset e Këmbimit të Monedhave të Huaja* (siç është rishikuar në 2003).**
- 9 **Fitimi ose humbja në pozicionin monetare neto duhet të përfshihet në fitimin ose humbjen dhe të jepet veças në informacionet shpjeguese.**
- 10 Riparaqitja e pasqyrave financiare në përputhje me këtë Standard kërkon zbatimin e disa procedurave si edhe të gjykimit. Zbatimi i njëjtë i këtyre procedurave dhe gjykimeve nga periudha në periudhë është më shumë i rëndësishëm se sa saktësia preçize e shumave që rezultojnë të cilat përfshihen në pasqyrat financiare të rideklaruara.

## **Pasqyrat financiare me kosto historike**

### **Bilanci kontabël**

- 11 Shumat e bilancit që nuk janë shprehur në vlerën e njësisë matëse aktuale në datën e bilancit riparaqiten duke zbatuar një indeks çmimesh të përgjithshëm.
- 12 Elementët monetarë nuk riparaqiten sepse ato tashmë janë të shprehur në vlerat e njësisë monetare aktuale në datën e bilancit. Elementët monetarë janë para të mbajtura dhe elementë që do të merren ose paguhën me para.
- 13 Aktivet dhe detyrimet që lidhen me marrëveshje për ndryshime në çmime, të tilla si indeksi i lidhur me obligacionet dhe huatë, rregullohen në përputhje me marrëveshjen në mënyrë që të pohojnë shumat pezull në datën e bilancit. Këto elementë mbarten me këtë shumë të rregulluar në bilancin e riparaqitur.
- 14 Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera janë jo monetare. Disa elementë jo-monetarë mbarten me shumat aktuale në datën e bilancit, të tilla si vlera neto e realizueshme dhe vlera e tregut, kështu që ato nuk riparaqiten. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera jo monetare riparaqiten.
- 15 Shumica e elementëve jo monetarë mbarten me kosto ose me kosto minus amortizimin; përderisa ato janë shprehur me shumat aktuale në datën e blerjes së tyre. Kosto, ose kosto minus amortizimin e riparaqitur te secilit element përcaktohet duke zbatuar ndaj koston së tij historike dhe amortizimit të akumuluar ndryshimin në indeksin e përgjithshëm të çmimeve nga data e blerjes deri në datën e bilancit. Kështu, aktivet afatgjata materiale, investimet, inventarët e lendëve të para dhe mallrave, emri i mirë, patentat, market tregëtare dhe aktivet e ngjashme riparaqiten qe nga datat e blerjes së tyre. Inventarët e mallrave pjesërisht të gatshme dhe të gatshme riparaqiten qe nga datat në të cilat kane ndodhur kostot e blerjes dhe prodhimit.
- 16 Rregjistrimet e hollësishme të datave të blerjes së elementëve të aktiveve afatgjatë materiale mund të mos jenë të disponueshme ose të mundura për t'u vlerësuar. Në këto rrethana të rralla, është e nevojshme, në periudhën e parë të zbatimit të këtij Standardi, të përdoret një vlerësim profesional i pavarur për vlerën e elementëve si bazë për riparaqitjen e tyre.
- 17 Indeksi i përgjithshëm i çmimeve mund të mos jetë i disponueshëm për periudhat për të cilat riparaqitja e aktiveve afatgjatë materiale kërkohe nga ky Standard. Në këto rrethana, mund të jetë e nevojshme të përdoret një çmuarje e bazuar, për shembull, në lëvizjet e kurseve të këmbimit mes monedhës funksionale dhe një monedhe të huaj relativisht të qëndrueshme.
- 18 Disa elementë jo monetarë mbarten me shumat aktuale në data të tjera nga ato të blerjes ose ato të bilancit, për shembull aktivet afatgjata materiale që kanë qënë rivlerësuar në një datë të dhënë të mëparshme. Në këto raste, vlerat kontabël riparaqiten nga data e rivlerësimit.

- 19 Shuma e riparaqitur e një elementi jo monetar ulet, në përputhje me Standardin përkatës, kur ajo tejkalon shumën e rikuperueshme nga përdorimi në të ardhmen të elementit (përfshirë shitjen ose dalje tjetër). Kështu në këto raste, shumat e rideklaruara të aktiveve afatgjata materiale, emrit të mirë, patentave dhe markave tregëtare ulen deri në shumën e rikuperueshme, shumat e rideklaruara të inventarëve ulen deri në vlerën e realizueshme neto dhe shumat e rideklaruara të investimeve aktuale ulen deri në vlerën e tregut.
- 20 Një njësi tek e cila kane investuar (i investuari), që është kontabilizuar sipas metodës së kapitalit të vet mund të raportojë në monedhën e një ekonomie hiperinflacioniste. Bilanci dhe pasqyra e të ardhurave e shpenzimeve e këtij të investuari riparaqiten në përputhje me këtë Standard në mënyrë që të llogaritet pjesa e investitorit në aktivet e tij neto dhe në rezultatet e operacioneve të tij. Kur pasqyrat financiare të rideklaruara të të investuarit janë shprehur në një monedhë të huaj ato përkthehen me kurset e këmbimit në mbyllje.
- 21 Ndikimi i inflacionit zakonisht njihet në kostot e huamarrjes. Nuk është e përshtatshme që edhe të riparaqitet shpenzimi kapital i financuar nga huamarrja edhe të kapitalizohet kjo pjesë e kostos së huamarrjes që kompenson inflacionin gjatë të njëjtës periudhë. Kjo pjesë e kostos së huamarrjes njihet si një shpenzim në periudhën në të cilën kryhen.
- 22 Një njësi ekonomike mund të blejë aktive sipas një marrëveshje që lejon shtyrjen e pagesës pa pësuar një shpenzim të veçantë për interesa. Kur është e pamundur të llogaritet shuma e interesit, këto aktive riparaqiten nga data e pagesës dhe jo nga data e blerjes.
- 23 [Fshirë]
- 24 Në fillimin e periudhës së parë të zbatimit të këtij Standardi, përbërësit e kapitalit të vet të pronarëve, përveç fitimeve të pashpërndara dhe ndonjë teprice nga rivlerësimi, riparaqiten duke zbatuar indeksin e përgjithshëm të çmimeve nga data që janë vënë si kontribut ose ndryshe janë krijuar. Çdo teprice nga rivlerësimi që është krijuar në periudhat e mëparshme eliminohet. Fitimet e pashpërndara të rideklaruara përftohen nga të gjitha shumat e tjera të rideklaruara në bilanc.
- 25 Në fund të periudhës së parë dhe në periudhat në vijim, të gjithë përbërësit e kapitalit të vet të pronarëve riparaqiten duke zbatuar indeksin e përgjithshëm të çmimeve nga fillimi i periudhës ose nga data e kontributit, nëse kjo ka ndodhur më vonë. Lëvizjet për periudhën në kapitalin e vet të pronarëve jepen në informacionet shpjeguese në përputhje me SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare*.

### **Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve**

- 26 Ky Standard kërkon që të gjithë elementët e pasqyrës së të ardhurave e shpenzimeve të shprehen në vlerën e njësisë matëse aktuale në datën e bilancit. Për këtë të gjitha shumat duhet të riparaqiten duke zbatuar ndryshimin në indeksin e përgjithshëm të çmimeve nga data kur këto elementë të të ardhurave dhe shpenzimeve janë regjistruar fillimisht në pasqyrat financiare.

### **Fitimi ose humbja në pozicionin monetar neto**

- 27 Në një periudhë me inflacion, një njësi ekonomike që ka më tepër aktive monetare se sa detyrime monetare humbet fuqi blerëse dhe një njësi ekonomike që ka më tepër detyrime monetare se sa aktive monetare fiton fuqi blerëse për aq sa aktivet dhe detyrimet nuk janë të lidhura me nivelin e çmimeve. Ky fitim ose kjo humbje në pozicionin monetar neto mund të llogaritet si diferencë që rezulton nga riparaqitja e elementëve jo monetarë aktive, kapitali i vet i pronarëve e të ardhura dhe rregullimi i aktiveve dhe detyrimeve të lidhura me indeksin. Fitimi ose humbja mund të vlerësohet duke zbatuar ndryshimin në indeksin e përgjithshëm të çmimeve me mesataren e ponderuar për periudhën të differences mes aktiveve monetare dhe detyrimeve monetare.
- 28 Fitimi ose humbja në pozicionin monetar neto përfshihet në të ardhurën neto. Rregullimi i këtyre aktiveve dhe detyrimeve të lidhura me marrëveshje me ndryshimet në çmimet të bëra në përputhje me paragrafin 13 kompenson kundrejt fitimit ose humbjes në pozicionin monetar neto. Elementët e tjerë të pasqyrës së të ardhurave e shpenzimeve, të tilla si të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi dhe diferencat nga konvertimi që lidhen me fondet e investuara ose të dhëna hua, gjithashtu shoqërohen me pozicion monetar neto. Megjithatë këto elementë jepen veças, është e dobishme nëse ato paraqiten sëbashku me fitimin ose humbjen në pozicionin monetar neto në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve.

## **Pasqyrat financiare me kosto aktuale**

### **Bilanci**

- 29 Elementët e paraqitur me kosto aktuale nuk riparaqiten sepse ata tashmë janë të shprehur në vlerat e njësisë monetare aktuale në datën e bilancit. Elementët e tjerë në bilanc riparaqiten në përputhje me paragrafët 11 deri 25.

### **Pasqyra e të ardhurave e shpenzimeve**

- 30 Pasqyra e të ardhurave e shpenzimeve me kosto aktuale, përpara riparaqitjes, në përgjithësi raporton kostot aktuale në kohën në të cilën kanë ndodhur transaksionet ose ngjarjet e tjera të dhëna. Kosto e shitjeve dhe amortizimi rregjistrohen me kostot aktuale në kohën kur konsumohen; shitjet dhe shpenzimet e tjera rregjistrohen me shumatat e tyre monetare kur ato ndodhin. Për këtë të gjitha shumatat duhet të riparaqiten me njësinë matëse aktuale në datën e bilancit duke zbatuar një indeks të përgjithshëm të çmimeve.

### **Fitimi ose humbja në pozicionin monetar neto**

- 31 Fitimi ose humbja në pozicionin monetar neto kontabilizohet në përputhje me paragrafët 27 dhe 28.

### **Tatimet**

- 32 Riparaqitja e pasqyrave financiare në përputhje me këtë Standard mund të krijojë diferenca mes vlerave kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të veçanta në bilanc dhe bazës së tyre tatimore. Këto diferenca kontabilizohen në përputhje me SNK 12 *Tatimet mbi të Ardhurat*.

### **Pasqyra e fluksit monetar**

- 33 Ky Standard kërkon që të gjithë elementët e pasqyrës së fluksit monetar të shprehen në vlerën e njësisë matëse aktuale në datën e bilancit.

### **Shifrat korresponduese**

- 34 Shifrat korresponduese për periudhat raportuese të mëparshme, qoftë kur ato janë bazuar në metodën e kostos historike, qoftë në metodën e kostos aktuale, riparaqiten duke zbatuar një indeks të përgjithshëm të çmimeve kështu që pasqyrat financiare krahasuese të paraqiten me vlerat e njësisë matëse aktuale në fund të periudhës raportuese. Informacioni që është dhënë në lidhje me periudhat e mëparshme gjithashtu shprehet me vlerat e njësisë matëse aktuale në fund të periudhës raportuese. Për qëllimin e paraqitjes së shumave krahasuese në një monedhë paraqitje të ndryshme, zbatohen paragrafët 42(b) dhe 43 të SNK 21 (siç është rishikuar në 2003).

### **Pasqyra financiare të konsoliduara**

- 35 Shoqëria mëmë që raporton në monedhën e një ekonomie hiperinflacioniste mund të ketë filiale që gjithashtu raportojnë në monedhën e ekonomive hiperinflacioniste. Pasqyrat financiare të secilit filial të tillë duhet të riparaqiten duke zbatuar një indeks të përgjithshëm të çmimeve të vendit në të cilin ai raporton në atë monedhë përpara se ato të përfshihen në pasqyrat financiare të konsoliduara të publikuara nga shoqëria e tij mëmë. Kur një filial i tillë është një filial në një vend tjetër, pasqyrat e tij financiare të rideklaruar përkthehen me kurset e këmbimit në mbyllje. Pasqyrat financiare të filialeve që nuk raportojnë në monedha të ekonomive hiperinflacioniste trajtohen në përputhje me SNK 21.

- 36 Në qoftë se konsolidohen pasqyrat financiare me data të ndryshme raportimi, të gjithë elementët, qoftë ato jo monetarë ose qoftë ato monetarë, duhet të riparaqiten me njësinë matëse aktuale në datën e pasqyrave financiare të konsoliduara.

## Zgjedhja dhe përdorimi i indeksit të përgjithshëm të çmimeve

- 37 Riparaqitja e pasqyrave financiare në përputhje me këtë Standard kërkon përdorimin e një indeksi të përgjithshëm të çmimeve që pasqyron ndryshimet në fuqinë blerëse të përgjithshme. Preferohet që të gjitha njësitë ekonomike që raportojnë në monedhën e të njëjtës ekonomi të përdorin të njëjtin indeks.

## Ekonomitë që nuk janë më hiperinflacioniste

---

- 38 Kur një ekonomi nuk është më hiperinflacioniste dhe njësitë ekonomike nuk vazhdon më përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare të bëra në përputhje me këtë Standard, ajo duhet të trajtojë shumat e shprehura në njësinë matëse aktuale në fund të periudhës raportuese të mëparshme si bazë për vlerat kontabël neto në pasqyrat e saj financiare vijuese.

## Dhënie Informacionesh Shpjeguese

---

- 39 Duhet të jepen informacionet shpjeguese si mëposhtë:
- (a) fakti që pasqyrat financiare dhe shifrat korresponduese për periudhat e mëparshme janë riparaqitur me ndryshimet në fuqinë blerëse të përgjithshme të monedhës funksionale dhe, si rrjedhim, janë paraqitur me vlerat e njësisë matëse aktuale në datën e bilancit;
  - (b) nëse pasqyrat financiare bazohen në metodën e kostos historike ose në metodën e kostos aktuale; dhe
  - (c) identitetin dhe nivel e indeksit të çmimeve në datën e bilancit dhe lëvizjet në indeks gjatë periudhës raportuese aktuale dhe të mëparshme.
- 40 Dhënia e informacioneve shpjeguese që kërkohen nga ky Standard nevojiten për ta bërë të qartë bazën e trajtimit të efekteve të inflacionit në pasqyrat financiare. Gjithashtu ato nevojiten për të dhënë informacione të tjera të duhura për të kuptuar këtë bazë dhe shumat që rezultojnë.

## Data e hyrjes në fuqi

---

- 41 Ky Standard bëhet i zbatueshëm për pasqyrat financiare që mbulojnë periudhat kontabël që fillojnë më ose mbas 1 janar 1990.